**Prishtine, data: 18.05.2021**

**KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE -** Ne baze të Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 3004 dt. 05.11.2012 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Avdullah Mustafa** pronar i kompanisë "Riviera&Toni-Com" sh.p.k me nr. biznesi 70598965 me adrese rr. Anton Ceta nr. 3, Prishtinë , merr këtë vendim :

INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS
DALJE
NR. PROT. 2035
DD.MM.YYYY 18.05.2021

## A K T V E N D I M

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave **Avdullah Mustafa** pronar i kompanisë "Riviera&Toni-Com" sh.p.k me nr. biznesi 70598965 me adrese rr. Anton Ceta nr. 3, Prishtinë, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

## A r s y e t i m

Ndaj **Avdullah Mustafa** pronar i kompanisë "Riviera&Toni-Com" sh.p.k me nr. biznesi 70598965 me adrese rr. Anton Ceta nr. 3, Prishtinë, KPMM ka leshuar aktin administartiv me 3004 dt. 05.11.2012.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 05.11.2012 dhe me dt.19.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .

Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Rr. Armend Daci nr.1
Prishtinë, Kosovë
**Tel:** +383 (38) 240 252
**Fax:** +383 (38) 245 844
**E-mail:** ICMM@kosovo-mining.org
**Web:** www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosova

**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova**
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

Prishtinë, 31.10.2012

Në pajtim me nenin 59 paragrafi 1 pika (e) e Rregullores 2005/3, dhe në bazë të nenit 2 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 04/10, lidhur me Metodologjinë për caktimin e gjobës për operuesit ilegalë, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

## AKTVENDIM

Ndaj Avdullah Mustafa pronar i kompanisë "Riviera & Toni - Com" Sh.p.k me nr. të biznesit 70598965, me adresë rruga Anton Çeta, 3 Prishtinë, i shqiptohet gjoba administrative lidhur me sasinë e mineraleve të shfrytëzuar ilegalisht në shumë prej 4,101.16€.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE
INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS
DEP SEK / DEP SEK / DEP SEK
NR PROT / BR PROT / NO PROT 3004
NUMRI I FAQEVE / BRO. STRANA / NO OF PAGES
DD MM VVVV / DD MM GGGG / DD MM YYYY 05/11/2012
PRISHTINË/A

## Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 08.09.2009, kompania "Riviera & Toni - Com" Sh.p.k është hasur duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e resurseve minerale të Rreshpeve. Shfrytëzimi është bërë në fshatin Vranidoll rreth 550 m nga rruga magjistrale Prishtinë - Podujevë. Inspektoret e Minierave kanë konstatuar se kompania juaj ka ushtruar aktivitet të paligjshëm pa u pajisur me Licence për Shfrytëzimin e mineraleve. Lloji i mineralit që kompania juaj shfrytëzonte ilegalisht ishte Rreshpe.

Inspektoret e Minierave kane konstatuar se kompania juaj me pronar Avdullah Mustafa aktivitetin e operimeve ilegale zhvillonte në lokacionin me këto koordinata: Y= 7512372, 7512416, 7512459, 7512441, 7512409, 7512373; X= 4737039, 4736029, 4737012, 4736991, 4737000, 4737005; Z= 581, 582, 580, 578, 576, 573 për të cilat koordinata nuk keni poseduar Licencë për Shfrytëzimin e Mineraleve.

Kompania "Riviera & Toni Com" sh.p.k ka gjobe administrative ne baze te raportit te inspektoratit te dates 14.09.2009 me numër protokolli 10020 me faturën për gjobe administrative me datë 15.09.2009, pa e llogaritur sasinë e mineraleve te shfrytëzuar nga ju ne ditën e inspektimit. Pas konstatimit nga Raporti i Departamentit të Gjeodezisë i datës 08.12.2009 me nr. protokolli 4765, sasia e mineralit te shfrytëzuar Rreshpe është 4,101.16 m$^3$.

Afati për kryerjen e pagesës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhirollogari 1000430070005950.

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
**Tel:** +381 (38) 240 252
**Fax:** +381 (38) 245 844
**E-mail:** ICMM@kosovo-mining.org
**Web:** www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa duke ju drejtuar Komisionit për Ankesa pranë KPMM-së në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Ankesa kundër këtij aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit sipas nenit 128 par.(a) të Ligjit për Procedurën Administrative.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së
Departamentit të Financave të KPMM-së
Palës

Selvete Grajqevci-Pllana
U.D e Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale